



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media
Mbledhja nr. 12
Prishtinë, më 09.07.08 ora: 14:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Esat Brajshori, Fehmi Mujota, Shpresa Murati, Melihate Tërmkolli, Gani Buçinca, Hajdin Abazi, Anita Morina, Synavere Rysha, Radmila Vujovic, Ali Lajçi dhe Rasim Selmanaj.

Nga zyra koordinuese e komisionit morën pjesë: Shpresa Ramosaj, Drita Morina, Fatime Qorri dhe Mirjeta Heta.

Mbledhjen e kryesoi kryetari i Komisionit, Esat Brajshori.

Për këtë mbledhje është propozuar ky rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës,**
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.**
- 3. Rishqyrtimi i Raportit me rekomandime në Projektligjin për Vulat në Institucionet e Republikës së Kosovës nga Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim.**
- 4. Të ndryshme.**

Kryesuesi, konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e mbledhjes dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua unanimisht.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar

Melihate Tërmkolli – pati vërejtje në procesverbal dhe propozoi që diskutimi i saj të formulohet si vijon:

– Komisioni nuk është kompetent, për ta shqyrtuar e aq më pak, me vendos për çështjen që paraqet amendamenti 2, sepse do të ishte tejkalim i kompetencës së komisionit me vendos lidhur

me harmonizimin e emërimit të Republikës së Kosovës në dokumente zyrtare duke propozuar që Kryesia e Kuvendit duhet të marrë vendim se si do të jetë vula në Institucionet e Republikës së Kosovës, në gjuhën serbe.

Kryetari i Komisionit - konstatoi se Komisioni miratoi procesverbalin e mbledhjes të dt. 04.07.08, me vërejtje.

3. Rishqyrtimi i Raportit me rekomandime në Projektligjin për Vulat në Institucionet e Republikës së Kosovës nga Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim dt. 09.06.08, nr. 03/0688.

Esat Brajshori – lidhur me pikën e rendit të ditës, i njoftoi anëtarët e komisionit për takimin e kryetarëve të komisioneve parlamentare që kishin patur me kryetarin e parlamentit në të cilin takim ndër të tjera ishte diskutuar edhe për amendamentin 2 të Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim në P/ligjin për Vula në Institucionet e Kosovës dhe rreth çështjes në fjalë, ai konfirmoi qëndrimin e Kryetarit të Parlamentit, nga ai takim, se duhet të veprohet konform Kushtetutës së Kosovës.

Gjithashtu, ai theksoi se qëllimi dhe arsyeja e rishqyrtimit të raportit me rekomandime në P/ligjin për Vula është harmonizimi i qëndrimeve konform Kushtetutës së Kosovës.

Fehmi Mujota – tha se çështja tani më është e sqaruar dhe nuk ka nevojë për diskutim të më tutjeshëm.

Melihate Tërmkollli - qëndron pranë diskutimit nga mbledhja e kaluar, nuk ka qenë kontestuese çështja se a të respektohet kushtetuta apo jo, ngase ajo dihet, por që Kryesia e Kuvendit të shqyrtojë çështjen ngase komisioni nuk është kompetent të bëjë harmonizimin në pajtim me kushtetutë.

Ajo shtoi se a është ky mekanizëm që ka me bë harmonizimin nëpërmjet të amendamentit të lartë përmendur që sipas saj, nuk është sqaruar ende.

Pas diskutimeve komisioni votoi unanimisht, pa asnjë votë kundër, për amendamentin 2 të Raportit me rekomandime nga Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim. dt. 09.06.08 në Projektligjin për Vulat në Institucionet e Republikës së Kosovës .

4. Pika e rendit të ditës – të ndryshme

Hajdin Abazi - pyeti ,a do të ketë komisioni ndonjë aktivitet në kohën e pushimeve.

Esat Brajshori - propozoi që brenda muajit korrik të vizitohet komuna e Prizrenit.

Mbledhja përfundoi në orën 14:16 min.

Përgatitur nga

Njësia për mbështetjen e Komisionit

**Kryetari i Komisionit
Esat Brajshori**